



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1337/Prot.

Elbasan më 31.12. 2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK PEQIN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj Nr.59, datë 19.12.2025 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, nëpunësve civilë dhe punonjësve administrativë të Bashkisë dhe të Institucioneve në varësi të Bashkisë Peqin”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PEQIN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 58 Prot.

Peqin më 12.12.2025

VENDIM

Nr. 58 Datë 12.12.2025

**“MBI MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR
OSE TË EMËRUAR, NËPUNËSVE CIVILË DHE PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË
TË BASHKISË DHE TË INSTITUCIONEVE NË VARËSI TË BASHKISË PEQIN”**

Mbështetur në shkronjën ç) dhe dh) të nenit 54 të Ligjit nr.139/2015”Për vetëqeverisjern vendore”, i ndryshuar, Ligjin nr.7961 datë 12.07.1995”Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr.152/2013”Për Nëpunësin Civil”, Ligjin nr.44 datë 30.04.2015”Kodi i Procedurave Administrative Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr.90/2012”Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, Ligji nr.152, datë 21.12.2015”Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”, Ligji nr.69/2012 “Per sistemin arsimor parauniversitar ne Republikën e Shqiperise”, Ligji nr. 10 129, datë 11.05.2009”Për Gjendjen Civile”, Ligji 89/2022”Për policinë bashkiake”VKM nr.328, datë 31.05.2023” Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, pika 10, pika 11, VKM nr.425, datë 26.06.2024”Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar” VKM nr.503, datë 01.08.2024”Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt

page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësisve të vetëqeverisjes vendore”, këshillit bashkiak:

VENDOSI:

1. Të miratojë numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë Peqin.
2. Numri maksimal i punonjësve të Bashkisë Peqin detajohet si më poshtë vijon;

a) Punonjës të aparatit administrative, të agjencive dhe institucioneve në vartësi të Bashkisë Peqin;	Gjithsej	229 (dyqind e njëzet e nëntë)
b) Gjendja Civile	“	5 (pesë)
c) SHMZSH	“	14 (katërmëdhjetë)
d) Arsimi Parashkollor	“	62 (gjashtëdhjetë e dy)
e) Bordi Kullimit dhe Shërbimi Pyjor	“	4 (katër)
3. Të miratojë strukturën dhe nivelin e pagave për punonjësit e Bashkisë Peqin sipas Lidhjes I bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi;
4. Të miratojë nivelin e shpërblimit të këshilltarëve, administratorëve të lagjeve dhe kryetarëve të fshatrave në masën 10% të pagës mujore të kryetarit të bashkisë dhe administratorëve të njësisve administrative;
5. Të ngarkohet aparati i Bashkisë Peqin për të identifikuar dhe propozuar ndryshimin e të gjitha vendimeve të këshillit bashkiak, për efekt të ndryshimeve që sjell ky vendim;
6. Ky vendim i shtrin efektet financiare duke filluar nga data 01.01.2026;
7. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

/Lulzim RESULI/



KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

/Zvjetllana SALLUFI/

